



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 30/2023 (JR)  
Nr. 30/2 regj.

Tiranë, më 27.03.2024

**SHPALLJE  
E  
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e hënë, në datën 29.04.2024, ora 10:00**, do të shqyrtohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri (JR) 30/2023, datë 14.07.2023 për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 675, datë 16.06.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Alfred Balla.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykes përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesuese e Trupit Gjykes**  
**Relatore e Çështjes**  
**Gjyqtar**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**

**Ina Rama**  
**Albana Shtylla**  
**Sokol Çomo**  
**Natasha Mulaj**  
**Rezarta Schuetz**

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publik.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARE**

**INA RAMA**

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë, e-mail: [info@kpa.al](mailto:info@kpa.al) ; [www.kpa.al](http://www.kpa.al)